

GRATË PA-STATUS NË KANADA: FAKTE

Arsyet pse njerëzit nuk kanë status në Kanada

- Shumë njerëz vijnë në Kanada me një leje të përkohshme qëndrimi. Nëse e kalojnë afatin e qëndrimit ata bëhen pa-status. Disa njerëz kanë qenë në Kanada pa status për 10, 20 ose më shumë vjet. Disa kanë qenë këtu që kur ishin fëmijë të vegjël dhe janë plotësisht të panjohur me vendin e tyre të origjinës drejt të cilit ato janë në rrezik të një deportimi.
- Shumë njerëz aplikojnë si refugjatë i cili i refuzohet, por preferojnë të qëndrojnë më mirë ilegal sesa të kthehen në një vend pa të ardhme ose ku i prët edhe vdekja.
- Shumë gra vijnë në Kanada në mënyrë legale (të sponsorizuara nga një punëdhënës, bashkëshorti, ose anëtar i familjës), por pastaj e gjejnë veten në një raport abuziv nga sponsorët e tyre. Nëse ato arratisen para se të pajisen me statusin e residentit permanent ato mund të bëhen pa-status.

Statistikat në numër të personave pa-status në Kanada

- Njerëzit që jetojnë pa status legal janë të detyruar të jetojnë të fshehur dhe të punojnë në mënyrë jo ligjore që të evitojnë ballafaqimin me autoritetet qeveritare dhe si konskuencë të deportohen. Për këtë arsye, është e pamundur të paraqitet një statistikë aktuale e saktë. Rezultatet variojnë diku nga 20,000 deri në 200,000 persona, por shumë besojnë që numrat janë shumë më të lartë.

Statistikat mbi Dhunën Ndaj Grave në Kanada

(Ju lutem vini re që këto statistika janë vetëm për gratë me status legal në Kanada. Nuk ka asnjë statistikë specifike të dhunës për gratë pa-status në Kanada, edhe pse gratë pa-status janë në një rrezik të vacant për të përjetuar dhunë për disa nga arsyet e shënuara më poshtë.)**

- Gjysma e grave kanadeze kanë përjetuar të paktën një incident abuzimi fizikë ose seksual që moshën 16-vjeçare
- Pothuajse gjysma (45%) e gjithë grave kanadeze kanë përjetuar dhunë nga burra të njohur nga vetë ato
- 1 në 4 gra kanadeze kanë përjetuar dhunë fizike ose seksuale nga bashkëshortet e tyre
- 63% e grave që janë keqtrajtuar nga partneri aktual ose ish partneri ose bashkëshorti janë viktimë më shumë se një rast.
- Një e treta e grave të keqtrajtuara nga partneri janë frikësuar për jetën e tyre në disa momente gjatë raportit abuziv
- Gratë që janë të ndara nga bashkëshortet e tyre posaqerishtë janë në rrezik të madh të vriten nga bashkëshorti

- Njëzet e pesë përqind e grave të cilat hynë në shtëpitë strehuese në vitin 1995 kishin lëndime që kërkonin ndihmë mjekësore, dhe 3% kërkonin shtrim në spital. (Bunge and Levett 1998, 19)
- Dyzet e dy përqind e grave invalide kanë qenë ose janë në raporte abusive. (DisAbled Women's Network 1989)
- Tetë në dhjetë gra Vendase në Ontario kanë raportuar se kanë përjetuar eksperiencë violente personale. (Ontario Native Women's Associatio 1989, 7)

Shumica e statistikave u moren nga webfaqet:

<http://www.cafv.inet2000.com/handouts/vaw/ViolenceAgainstWomeninCanada.htm>

Pengesat që ballafaqohen gratë pa-status dhe fëmijët në Kanada

- Kufizimi në arsim (i cili është ESL & edukimi publik)
- Kufizimi/Pamjaftueshmëri në përkujdesje shëndetësie
- Kufizimi/Strehim i pamjatuëshëm
- Kufizimi për të drejtën e shërbimeve
- Diskriminim
- Paramendim
- Racizëm
- Gjinia
- Abuzim (fizik, seksual, emocional)
- Pengesa në gjuhë
- Papunësi/Punë me gjysmë orari
- Shfrytëzim nga punëdhënësi
- Frikë nga deportimi
- Izolim
- Frikë nga përdorimi i shërbimeve 911

Pse gratë pa-status janë në rrezik të madh të një eksperiece të dhunshme?

Grate pa-status hasin të njëjta forma të dhunës si të gjitha gratë tjera, por janë në një rrezik më të madh për faktin që jetojnë në një pozitë të mjerueshme.

- Ato kanë shumë pak informacion, konsultim dhe shërbime të tjera sociale ose nuk kanë aspak.
- Ato nuk mundën të lajmërojnë policinë në raste urgjente për vetë faktin se rrezikojnë vetën e tyre nga deportimi, sepse policia ka autorizimin të arrestojë ose paraburgosë në emër të Emigracioni.
- Nëse partneri i saj është arrestuar për keqtrajtim kjo mund të sjellë pasoja të rënda edhe për vetë atë.
- Ato nuk e kanë lehtë të përfitojnë nga shërbimet mjekësore.

Çfar duhët bërë?

- Rregullimin e të gjithë njerëzve pa-status në Kanada
- Të mos u kërkohet statusi i emigrantit ose raportimi në Emigracion nga policia ose nga subjektet tjera shërbyese. Një rregullore nga “Don’t Ask, Don’t Tell” (“Mos Pyet, Mos Trego” do t’i bënte të mundur shërbimet e qytetit për të gjithë banorët e qyteti, pa diskriminim për sa i përket statusit të emigrantit.
- Ndryshime në ligjet e emigracionit për mbrojtjen e grave pa-status nga sponsored apo punëdhënësit e tyre.

Fushata në ndihmë personave pa-status.

STATUSI është një bashkim i madh i individëve ose organizatava në mbrojtje për rregullimin e statusit për të gjithë emigrantet që jetojnë pa-status në Kanadë. E-maili është: status@ocasi.org ose telefononi: 416 322-4950 ext. 239

Fushata **Don’t Ask Don’t Tell (Mos Pyet Mos Trego)** është duke u organizuar nga një koalicion me bazë në Greater Toronto Area (Zona e Përgjithshme e Torontos). Zyrtarisht ka filluar nga No One Is Illegal Toronto (Asnjë Nuk Është Ilegal Toronto) në Mars të vitit 2004. E-maili është: info@dadttoronto.org

Kjo faqe fakti është krijuar nga **Rights of Non-Status Women Network (Rrjeti për Të Drejtat e Grave Pa-Status)**. Rights of Non-Status Women Network është një rrjet pune i organizuar nga agjensitë dhe pjestarët e komuniteteve në Toronto. Mandati yne është të u drejtohem pengesave të shërbimeve dhe burimeve që hasin gratë pa-status të prekura nga dhuna që kanë për bazë gjininë, përmes një koordinimi edukativ publik dhe mbrojtje me qëllim ndryshimin e sistemit.

Për më shumë informacione ose të merrni pjesë, ju lutem kontaktoni: Clara Ho, nga METRAC (426-392-3135) ose Amelie Roy, Menaxhere e Programit në Woman Abuse Council of Toronto (Këshilli i Grave të Abuzuar në Toronto) (416-944-9242, ext. 228; amelier@womanabuse.ca).

Në qoftë se jeni një grua në krizë ose njihni dike që është duke u keqtrajtuar, ju lutem kontaktoni linjen ndihmese Assaulted Women’s Helpline (Linjën Ndihmës Gratë e Keqtrajtuara) në numrin 1-866-863-0511 ose 1-866-863-7868 (TTY)